

Data 28.09.2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje Kite Reagentë për Laboratorin Klinik-Biokimik” – Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik të vetëm të suksesshëm, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Reagentë për laborator 33696500-0

VLERA E FONDIT LIMIT: Vlera e pritshme e kontratave që mund të lidhen gjatë Marrëveshjes Kuadër: **39 209 955** (Tridhjetë e nëntë milion e dyqind e nëntë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e pesë) **Lekë pa TVSH**.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti/enti kontraktor *Spitali Rajonal Memorial Fier* ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;

Argumentimi:Ky kriter u vendos sipas nenit 29 te VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik“, ne te cilen eshte e parashikuar se:

- 1. Oferta ekonomike përmban vlerën ekonomike pa TVSH.*
- 2. Operatori ekonomik duhet të hartojë në mënyrë të pavarur, ofertën ekonomike.*

b. Lista e cmimeve te artikujve, sipas Shtojcës 2;

Argumentimi:*Kjo shtojce eshte pjese e setit te dokumenteve standarte te tenderit per proceduren e prokurimit te sipercituara.*

c. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;

Argumentimi:Ky kriter u vendos me mbeshtetje ne nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020“Për Prokurimin Publik“, dhe nenin 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik“,ne te cilen eshte e percaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa

vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”.

ç. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ne te cilen eshte e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe ne nenin 30 te VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit .

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Vërtetim nga Dega e Tatimeve për xhiron vjetore të realizuar gjate **3 (tre) viteve** te fundit (**2020, 2021, 2022**), ku vlera e xhiros **për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e ulët se 35 000 000 lekë**, (pra kjo vlerë e xhiros minimale vjetore nuk tejkalon vlerën e parashikuar të kësaj kontrate).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.Referuar parashikimeve ligjore të nenit 43, pika 2, germa ”b”, për procedurat me objekt shërbime me fond limit ndërmjet kufirit të ulët dhe të lartë monetar, siç është rasti i kësaj procedure, maksimumi i xhiros vjetore te kerkuar nuk duhet te tejkaloje vlerën e parashikuar të kësaj kontrate.Kjo është një kërkesë e cila nuk e pengon konkurrencën dhe është e bazuar në garancinë që ofertuesi i paraqet Autoritetit Kontraktor per besueshmerine dhe qendrushmerine e tij.

Vendosja e ketij kriteri behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine ekonomike dhe financiare te OE ofertues, duke vertetuar nepermjet dokumenteve te kerkuara se

zoterojne kapacitet ekonomike dhe financiare per te permbushur kontraten sic eshte parashikuar nga AK.

2.3 Kapaciteti teknik:

Dëshmi nga operatori ekonomik për furnizime të mëparshme të ngjashme për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të ulët se **15 000 000 lekë** (pra kjo vlerë totale e kontratave të mëparshme të realizuara gjatë tre viteve të fundit nuk tejkalon 40% të vlerës së parashikuar të kontratës),

- Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi për kriterin 2.3.1: Ky kriter u vendos në përputhje me piken 4 te nenit 77 te Ligjit nr. 162/2020, "Per Prokurimin Publik", ne te cilin gjejme te percaktuar se: 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; si dhe me piken 4 te nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", ne te cilen eshte e percaktuar se: [...]4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi

pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara; si dhe me piken 4 te nenit 55 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ne te cilen eshte e percaktuar se: [...]Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara duhet të jetë:4. (b)Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Vendosja e këtij kriteri behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine teknike te OE ofertues, nepermjet pervojave te duhura, qe jane ne perpjesetim me natyren e objektit te prokurimit dhe qe ka aftesine e duhur per zbatimin e kontrates sic eshte parashikuar nga AK.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqese çertifikatën **ISO 9001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, me objekt aktiviteti të certifikates per tregetim të materialeve mjekësore ose ekuivalent në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise. Çertifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Argumentimi per kriterin 2.3.2: Në bazë të nenit 79/1 , të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” si dhe neneve 40 si dhe 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që Autoriteti ose enti kontraktor të vërtetojë se mallrat objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin çertifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. Bazuar në këto dispozita Autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë ofertuesve dorëzimin e certifikatave ose dokumenteve të ngjashme, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë, veçanërisht sa i takon:a) garantimit të aksesit të personave me aftësi të kufizuara;b) efikasitetit të energjisë;c) sistemeve të menaxhimit mjedisor.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë vetëdeklarim se të gjitha materialet nga ofertuesi janë konform Direktivave dhe klasifikimit të Këshillit të Europës, bashkëlidhur me kopjet e certifikatave përkatëse CE/DC (Deklarate konformiteti) ose FDA, origjinale ose fotokopje të perkthyer dhe të noterizuara të vlefshme në momentin e dorëzimit të ofertave, kur eshte e aplikueshme.

Argumentimi për kriterin 2.3.3 : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, pika 3.4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik ”.Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se Certifikatat përkatëse që i mundëson Autoritetit Kontraktor

për të verifikuar dhe krijuar besimin që OE ofertues është në gjendje të realizojë punën/shërbimin në mënyrë cilësore që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë origjinën e mallit dhe kompaninë prodhuese

Argumentimi për kriterin 2.3.4: Ky kriter vendoset me qëllim njohjen e origjinës së mallit dhe kompaninë prodhuese për të identifikuar në mënyrë të qartë atë gjatë lëvrimit të tij dhe për të pasur sigurinë që i njëjti mall i ofertuar do të lëvrohet në destinacion ne perputhje me nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, dhe keto kërkesa i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses te kontrates pra te garancisë së furnizimit të mallit objekt prokurimi.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga kompania prodhuese ose nga Distributor të Autorizuar nga prodhuesi, për këtë procedurë prokurimi, për tregëtimin e artikujve të ofruar (Dokumentat duhet te jene te perkthyer dhe te noterizuara).

Shënim: Në rastin e distributorit të autorizuar të provohet lidhja me prodhuesin nëpërmjet dokumentacionit përkatës (Dokumentat duhet te jene te perkthyer dhe te noterizuara).

Argumentimi për kriterin 2.3.5: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar ne pikat 2 dhe 4 te nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe piken 5 te nenit 44 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ku eshte e cituar: Pika 5. *”Kur është e dukshme që një operator ekonomik e ka të pamundur të marrë etiketën specifike, të cilësuar nga autoriteti/entikontraktor ose një etiketë ekuivalente, brenda afateve kohore përkatëse, për shkaqe që nuk lidhen me atë operator ekonomik, autoriteti ose enti kontraktor pranon mënyra të tjera vërtetimi të përshtatshme, që mund të përfshijnë një dosje teknike nga prodhuesi, nëse operatori ekonomik në fjalë vërteton se punët, furnizimet ose shërbimet që ai duhet të ofrojë përmbushin kërkesat e etiketës specifike ose kërkesat specifike të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor .*

Autorizimi per OE ofertues nga firma prodhuese ose nga distributori i autorizuar prej prodhuesit është një dokument i domosdoshëm për t’u paraqitur, në mënyrë që autoriteti kontraktor të sigurohet që subjekti/shoqëria që disponon këtë dokument, autorizon operatorin ekonomik që ta furnizojë me produktet e tij; domosdoshmëria e tij lidhet me garancinë e mallit të cilën e jep prodhuesi dhe jo operatori ekonomik ofertues (*ref. Vendimit te KPP nr. 353/2014*). Si dhe gjithashtu ky kriter u vendos ne mbeshtetje te **Rekomandimit nr. 3341/1 prot. Date 20.03.2018 te Agjensise se Prokurimit Publik** (Drejtoria Juridike dhe Monitorimit) drejtuar Autoriteteve Kontraktore **”Rekomandim mbi hartimin e kriterëve per kualifikim ne dokumentet e tenderit te procedurave te prokurimit publik”**.

2.3.6 Kërkohen të paraqiten katalogë teknikë për të gjithë artikujt e ofruar. Në katalogë, artikujt dhe specifikimet teknike të tyre duhet të markohen me ngjyrë të ndezur. Dokumentat duhet te jene te perkthyer dhe te noterizuara.

Argumentimi kriterin 2.3.6: Këto kriterë janë vendosur nga anetari i Njesise se Prokurimit qe ka specialitet perkatese ne lidhje me kriteret teknike si dhe eshte ne perputhje me nenin 4 pika 38/b,

nenin 36 dhe 77 te Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik, si dhe me piken 6/b te nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ne te cilen eshte e percaktuar se:[...] 6. *Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: [...] b. fotografitë apo katalogët teknikë; [...].* Paraqitja e katalogjeve per te gjithë artikujt qe jane objekt prokurimi, eshte kerkuar me qellim verifikimin e perpuethshmerise se materialeve mjekesore qe operatori ekonomik oferton, me specifikimet teknike te percaktuara ne DST ne Shtojcen 5. Objekti i prokurimit është specifik, dhe impakti që ka finalizimi me sukses i kësaj kontrate sjell përfitimi në fushën e diagnostikimit të disa lloje sëmundjes gjenetike etj., dhe për pasojë në zgjedhjen e terapisë së duhur.

2.3.7 Operoret ekonomike duhet te paraqesin nje vetedeklarim ku te deklarohet qe skadencia e mallrave do te jete sipas kushteve te percaktuara ne specifikimet teknike.

Argumentimi kriterin 2.3.7 : Ky kriter eshte vendosur në përputhje me nenin 77 ‘Kërkesat për kualifikim’, pika 1 e **Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik”** ku parashikohet që: *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. Vendosja e këtij kriteri në formë deklarative është në përputhje me nenin 1 dhe 2 të e **Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik”**.*

Per Paisjet qe ve ne perdorim prane SRMF :

a. Autodeklarate ku saktësohet nr. dhe tipi i analizatoreve perfshire aksesoret e tij te cilet OE do t’i instaloje duke bashkelidhur materialin pershkruar:

b. lloji i paisjes, modeli, viti i prodhimit, kompania prodhuese, vendi i prodhimit, gamen e plote te analizave te cilat propozon dhe eshte ne gjendje te beje sistemi

Shenim. Apartura dhe aksesoret te jene sipas specifikimeve teknike te DS. Gjithashtu te ofrohet nje sistem back up i aparatures shoqeruar me listen e aksesoreve i cili duhet te jete ne perputhje me specifikimet teknike te kerkuara te pajisjes, te reagenteve dhe afatit te levrimit te pasqyruara ne DS.

c. Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga kompania prodhuese ose nga Distributor të Autorizuar nga prodhuesi, për ofrimin e paisjeve te kerkuara ne funksion te perdorimit te testeve nga AK sipas specifikimeve teknike te DT.(Dokumentat duhet te jene te perkthyer dhe te noterizuara).

Shënim: Në rastin e distributorit të autorizuar të provohet lidhja me prodhuesin nëpërmjet dokumentacionit përkatës. (Dokumentat duhet te jene te perkthyer dhe te noterizuara).

d.Kërkohen të paraqiten katalogë teknikë për të gjithë artikujt e ofruar. (paisjeve) Në katalogë, artikujt dhe specifikimet teknike të tyre duhet të markohen me ngjyrë të ndezur. (Katalogët duhet të ngarkohen në eëë.app.gov.al së bashku me dokumentacionin e kërkuar në këto DT . (Dokumentat duhet të jene te perkthyer dhe te noterizuara).

e. Vetedeklarim qe bashke me sasine e reagenteve do te siguroje edhe paisjet sipas kerkesave te DST.

f.Deklarate per trajnimin e personelit qe do te perdore aparaturat dhe do te kryeje analizat .

Shënim: KVO rezervon të drejtën e verifikimit të të dhënave të paraqitura nga ofertuesit

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Argumentimi: Keto kriteret janë vendosur në përputhje me nenin 77 ‘Kërkesat për kualifikim’, pika 1 e Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik” ku parashikohet që:: *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.* Vendosja e këtij kriteri në formë deklarative është në përputhje me nenin 1 dhe 2 të e Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik”, dhe në përputhje me objektin e kontratës.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Nr	Kite reagent	Njësia
1	Solucion per numerimin e RBC dhe trombociteve per aparatn Hematologjik	cope
2	Solucion per numerimin dhe diferencimin e WBC per aparatn Hematologjik	cope
3	Kit per matjen sasiore te Kreatinines (Metoda Jaffe) ne serum dhe plasem	Test

4	Kit per matjen sasiore te Urese ne serum plasem dhe urine	Test
5	Kit per matjen sasiore te Glukozes ne serum, plasem, urine dhe CSF	Test
6	Kit per matjen sasiore te Alanine Aminotranferases ne serum dhe plasem	Test
7	Kit per matjen sasiore te Aspartat Aminotransferases ne serum dhe plasem	Test
8	Kit per matjen sasiore te Bilirubines Totale ne serum dhe plasem tek neonatet dhe adultet	Test
9	Elektrode per matje e Cl-	cope
10	Elektrode per matjen e Potasiumit (K+)	cope
11	Elektrode per matjen e Sodiumit (Na+)	cope
12	Kit per matjen e proteines c reaktive	Test
13	Stripe urine te cilat analizohen (lexohen) ne aparat	Test
14	Kit per matjen sasiore te Kolesterolit për ekzaminimi laboratorik : Lipid.Total	Test
15	Kit per matjen sasiore te HDL për ekzaminimi laboratorik : Lipid.Total	Test
16	Kit per matjen sasiore te LDL për ekzaminimi laboratorik : Lipid.Total	Test
17	Kit per matjen sasiore te Triglicerideve për ekzaminimi laboratorik : Lipid.Total	Test
18	Kit per matjen sasiore te Acidit Urik	Test

19	Kit per matjen sasiore te Bilirubines Direkte ne serum dhe plasem	Test
20	Kit per matjen sasiore te Kalciumit ne serum, plasem dhe urine	Test
21	Kit per matjen sasiore te Albumines ne serum dhe plasem	Test
22	Kit per matjen sasiore te TSH imunologjike	Test
23	Kit per matjen sasiore te Proteinave Total	Test
24	Kit per matjen sasiore te HbA1c	Test
25	Kit per matjen sasiore te D Dimerit imunologjike	Test
26	Kit per matjen sasiore te Kreatinine Kinases ne serum dhe plasem	Test
27	Kit per matjen sasiore te Alkaline Fosfates ne serum dhe plasem	Test
28	Kit per matjen sasiore te Gamma Glutamyl Transferase 2 (GGT-2) ne serum	Test
29	Reagent per matjen e aPTT me metoden SDV ose ekuivalent	kuti
30	Buffer OWren Koller (24 x 15 mL) ose ekuivalent	kuti
32	Reagent per percaktimin e Kohes se Aktivizimit te Tromboplastines (aPTT: 6 x 2 mL) ose ekuivalent	kuti
33	Kit per matjen sasiore te Faktorit Reumatologjik	Test
34	Reagent per matjen e PT/INR me metoden SDV ose ekuivalent	kuti

35	Reagent CaCl ₂ 0.025 M (24 x 15 mL) ose ekuivalent	kuti
36	Reagent per matjen e kohes se Protrombines CI+5 (PT: 6 x 5 mL) ose ekuivalent	kuti
37	Kit per matjen sasiore te FT4 imunologjike	Test
38	Kit per matjen sasiore te FT3 imunologjike	Test
39	Kit per matjen sasiore te LDH	Test
40	Kit per matjen sasiore te Troponin I imunologjike	Test
41	Kit per matjen sasiore te Ferritines imunologjike	Test
42	Reagent likuid per matjen sasiore te Fibrinigenit me metoden Clauss (12 x 4 mL) ose ekuivalent	kuti
43	Kit per matjen sasiore te CKMB	Test
44	Kit per matjen sasiore te Hekurit	Test
45	Kit per matjen sasiore te PSA totale imunologjike	Test
46	Kit per matjen sasiore te Fosforit	Test
47	Kit per matjen sasiore te TPO neperjet metodes imunologjike	Test
48	Kit per matjen sasiore te Magnesiumit	Test
49	Kit per matjen sasiore te Triglicerideve	Test

50	Kit per matjen sasiore te Amilases ne serum plasem dhe urine	Test
51	Kit per matjen sasiore te Kolesterolit	Test
52	Kit per matjen sasiore te CEA imunologjike	Test
53	Kit per matjen sasiore te HDL	Test
54	Kit per matjen sasiore te LDL	Test
55	Katrixh per matjen e gazeve elektroliteve dhe Kalciumit te jonizuar ne gjak x 25 teste ose ekuivalent	kit
56	Kit per matjen sasiore te Lipases n�p�rmjet medtod�s kolorimetrike	Test
57	Kit per matjen sasiore te CKMB imunologjike	Test
58	Kit per matjen sasiore te CA 19-9 imunologjike	Test
59	Kit per matjen sasiore te FPSA imunologjike	Test
60	Kit per matjen sasiore te PROBNP imunologjike	Test
61	Kit per matjen sasiore te komplementit C4	Test
62	Kit per matjen sasiore te komplementit C3	Test
63	Kite per matjen sasiore te Cholinestrases	Test
64	Kit p�r matjes cil�sore t� HBV (HbsAg) imunologjike	Test

65	Kit për matjes cilësore të HCV (anti HCV) imunologjike	Test
66	Rapid test feçe gjak okult	Test
67	Rapid test për helikobakter në feçe	Test

Kryerja e games se plote te te gjitha analizave biokimike dhe Imunologjike nepermejt sistemit te Integruar te paisjeve perkatesisht te testeve 3-8, 12, 14-28, 33, 37-41, 43-54, 56-65.

Specifikimet e paisjeve ne perdorim:

- **Analizator Imunologjik**

Te ofrohet ne perdorim aparat per realizimin e analizave imunologjike me karakteristikat si me poshte:

- Sistem imuno-analizues i automatizuar i cili bazohet në parimin e Kemiluminishences ose ekuivalent

-Kapaciteti minimal rreth 90 teste/ore

-Tipi i mostres se analizuar: serum, plasmë, gjak i plote, urine

-Hollimi automatik i mostres

-Te jete e pajisur me sistem ftohje te integruar per te mundesuar stabilitetin e reagenteve ne aparat.

-Te ofroje mundesine e detektimit te koagolave apo flluskave te krijuara ne moster

- Operatori Ekonomik merr përsipër te kontribuojë ne lidhjen e pajisjeve të ofruara në sistemin LIS dhe ofron mirembajtjen e pajisjeve deri ne mbarimin e plote te artikujve te prokuruar.

- **Paisje Biokimike**

Te ofrohen ne perdorim 2 aparate biokimike plotesisht te automatizuar qe nga procesi i kalibrimit, kontrollit dhe testimit me karakteristikat e meposhtme:

Aparati Kryesor:

- Aparat plotesisht automatik i integruar me aparatën Immunologjik
- Metodologjia: Integrim i 3 parimeve matese: Fotometri Turbidimetri, Potenciometri
- Kapaciteti jo me pak se 800 teste/ ore
- Tipologjia e mostres se perdorur: serum, plasmë, urine, CSF dhe gjak komplet
- Aparati duhet te realizoje hollim automatik te mostrave
- Identifikimi I mostrave duhet te realizohet nepermjet lexuesit automatik te barkodeve
- Te jete e pajisur me sistem ftohje te integruar per te mundesuar stabilitetin e reagenteve ne aparat.
- Operatori ekonomik duhet te ofroje aparatën per distilimin e ujit nese nevojitet per zbatimin e protokollit te testeve biokimike si edhe materialeve te konsumit per kete aparat.
- Operatori Ekonomik merr përsipër te kontribuojë ne lidhjen e pajisjeve të ofruara në sistemin LIS dhe ofron mirembajtjen e pajisjeve deri ne mbarimin e plote te artikujve te prokuruar
- Operatori Ekonomik duhet të ofrojë së bashku me aparaturën dhe materialet e konsumit të domosdoshme për 12 muaj për funksionimin e paisjes.

Aparatet Immunologjike dhe Biokimike back up:

- Operatori ekonomik te ofroje mundesine e nje aparati back up per kryerjen e analizave Immunologjike me karakteristikat si me poshte vijon:
- Sistem imuno-analizues i automatizuar i cili bazohet në parimin e Kemiluminishences ose ekuivalent
- Rezultati te perftohet minimalisht ne 20 min dhe maksimalisht ne 120 minuta (ne varesi te parametrave te testuar).
- Analizim i njekohshem i parametrave te ndryshem.
- Monitori, tastiera dhe printeri te integruar ne aparat.
- Identifikimi i mostrave: nepermjet nje lexuesi barkodi te jashtem.
- Te kete kapacitet maksimal jo me te vogel se 10 teste.

Operatori ekonomik te ofroje mundesine e nje aparati back up per kryerjen e analizave Biokimike me karakteristikat si me poshte vijon:

-Metodologjia: Integrim i 4 parimeve matese: Fotometri absorbance, Turbidimetri, Polarimetri fluoeshente, Potenciometri (jon selective)

-Kapaciteti rreth 400 teste/ ore

-Tipologjia e mostres se perdorur: serum, plasme, urine, CSF, hemolizat dhe gjak komplet (HbA1c)

-Aparati duhet te realizoje hollim automatik te mostrave

-Identifikimi I mostrave duhet te realizohet nepermjet lexuesit automatik te barkodeve

-Te ofroje mundesine e analizimit prioritar te mostrave STAT.

-Të punojnë me ngarkesë të vazhdueshme

- **Analizator Hematologjik**

Platforma në përdorim duhet të përbëhet nga dy pajisje automatike të cilat duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

-Rezultate per 26 parametra te raportueshme duke përfshirë P-LCC, P-LCR

-Te perdore teknikat:Floë Citometri (laser me 3 kende) per numerimin dhe diferencimin e ËBC, metoden e impedancës elektrike për numërimin e RBC dhe trombociteve

-Vëllimi maksimal i mostrës 25 µl

-Kapaciteti maksimal jo me pak se 60 mostra/orë

-Te kete kapacitet te ruajtjes jo me pak se 40000 rezultate (me grafiket perkates)

-Te mundesje matjen e hemoglobines perms metodes se kolorimetrise (reagent pa cyanide).

-Identifikimi i mostrave te realizohet nepermjet nje lexuesi barkodi te jashtem

-Printer per printimin e pergjigjeve te analizave

- Operatori Ekonomik merr përsipër te kontribuojë ne lidhjen e pajisjeve të ofruara në sistemin LIS dhe ofron mirembajtjen e pajisjeve deri ne mbarimin e plote te artikujve te prokuruar.

- **Analizator per Gazet ne Gjak**

Te ofrohet ne perdorim aparat portable I bazuar ne perdorimin e katrixheve per te analizuar gazet ne gjak, elektrolitet, markerat kardiake, faktoret e koagolimit.

Karakteristikat e Aparatit:

-Rezultati i analizes te perftohet ne intervalin kohor minimal jo me shume se 2 min dhe maksimal jo me shume se 20 min (ne varesi te testit te realizuar).

-Mostra e perdorur gjak i plote dhe plasme

-Te perdore metoden e matjes direkte elektrokimike.

- **Analizator Elektrolitik**

Te ofrohet ne perdorim aparat plotesisht automatik per matjen e elektroliteve ne 95 µl moster perkatesisht:

-Gjak komplet, serum, plasem te mund te testohen elektrolitet: Na⁺, K⁺, Cl⁻, Ca²⁺, Li⁺,

-Bikarbonat dializat te mund te testohen elektrolitet (Na⁺, K⁺, Cl⁻, Ca²⁺),

-Urine e holluar te mund te testohen elektrolitet (Na⁺, K⁺, Cl⁻)

-Kohezgjatja e analizes jo me shume se 1 minute.

-Kapaciteti testues jo me pak se 45 mostra/ore

-Metodologjia e matjes: elektrode kapilare per matjen e Natriumit dhe elektrode memebranore e lengshme per matjen e elektroliteve te tjere (K⁺, Cl⁻, Ca²⁺, Li⁺),

- Operatori Ekonomik merr përsipër të kontribuojë në lidhjen e pajisjeve të ofruara në sistemin LIS dhe ofron mirembajtjen e pajisjeve deri në mbarimin e plote të artikujve të prokuruar

- **Analizator Koagulimi**

Platforma në përdorim duhet të përbëhet nga dy pajisje (kryesore dhe back-up) të cilat duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

Aparati kryesor plotesisht i automatizuar:

-Metodologjia: Sistemi I detektimit I bazuar ne viskozitet.

Kapaciteti jo me pak se 100 mostra per testin PT, jo me pak se 100 mostra per testin APPTT, jo me pak se 100 mostra per testin Fibrinogjen.

-Te ofroje mundesine e analizimit prioritar te mostrave STAT.

-Te realizoje hollimin automatik te mostrave

-Paisja duhet te realizoje back up automatik.

-Paisja duhet te identifikojë mostrat positive.

Aparati back up gjysëautomatik:

-Metodologjia: Sistemi I detektimit I bazuar ne viskozitet

-Te jete i paisur me te pakten 4 kohemates te inkorporuar ne aparat me alarm zanor.

-Operatori Ekonomik merr përsipër te kontribuojë ne lidhjen e pajisjeve të ofruara në sistemin LIS dhe ofron mirembajtjen e pajisjeve deri ne mbarimin e plote te artikujve te prokuruar

-Operatori Ekonomik duhet të ofrojë së bashku me aparaturën dhe materialet e konsumit të domosdoshme për 12 muaj për funksionimin e paisjes

- **Analizator Urine**

Te ofrohet ne perdorim aparat gjysmeautomatik per analizimin e stripeve te urines me karakteristikat e meposhtme:

-Metodologjia: Fotometri reflektance.

- Kapaciteti jo me pak se 400 stripe urine/ore

-Te kete kapacitet te ruajtjes deri ne 1000 rezultate te mostrave dhe jo me shume se 300 rezultate te kontrolleve

-Printeri: Termal printer

-Parametrat e analizuar: pesha specifike, ph, leukocitet, nitrite, proteina, glukoza, ketonet, urobilinogen, bilirubine, eitrocite, hemoglobine, ngjyra.

-Te ofrohet mundesia e kalibrimit te testeve.

-Identifikimi i mostrave: manualisht ose nepermjet nje lexuesi barkodi te jashtem.

-Operatori Ekonomik merr përsipër te kontribuojë ne lidhjen e pajisjeve të ofruara në sistemin LIS dhe ofron mirembajtjen e pajisjeve deri ne mbarimin e plote te artikujve te prokuruar.

Operatori Ekonomik merr përsipër të ofrojë kitet për kalibrimin, kontrollin dhe materialet e nevojshme të konsumit që janë të domosdoshme për ecurinë normale të punës së paisjeve të lartpërmendura.

Operatori Ekonomik merr përsipër të ofrojë në përdorim pajisjet ndihmëse për mbarevajtjen optimale të procesit të punës si më poshtë vijon:

- **Centrifuge (2 cope)**

Te jepen në përdorim 2 centrifuga për tubat e gjakut dhe urinës me karakteristikat si më poshtë:

Centrifuge me rotor të lirë dhe kapacitet 30- 40x13mm për tubat e gjakut dhe centrifuge me rotor të fiksuar dhe kapacitet 20x15ml për tubat e urinës.

- **Mikroskop (1 cope)**

Te jepet në përdorim 1 mikroskop për ekzaminimin e gjakut dhe urinës:

Mikroskop binokular me BE2 plan achromat.

Ndricimi: LED

Zmadhimi maksimal: 100x

- **Pajisjet ndihmëse si më poshtë vijon:**

Perzieres për tubat e gjakut (1 cope)

Homogjenizues tubash (1 cope)

Barcode Printer dhe materialet e konsumit përkatëse (1 cope)

Pipeta (4 cope)

✓ Koha e dorëzimit, instalimit dhe vendosjes në punë të aparateve do të jetë 7 ditë nga momenti i lidhjes së kontratës.

Argumentimi për specifikimet teknike janë vendosur bazuar në procesverbalin nr. 1158/2 datë 14/09/2023 të komisionit të hartimit i specifikimeve teknike për kite reagente për procedurën e

prokurimit me objekt: “Blerje Kite Reagentë për Laboratorin Klinik-Biokimik”si dhe ne perputhje me nenin 4,pika 38/b, nenin 36 te Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik”, nenin 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet: “Blerje Kite Reagentë për Laboratorin Klinik-Biokimik”

Nr	Kite reagent	Njësia	Sasia
1	Solucion per numerimin e RBC dhe trombociteve per aparatin Hematologjik	cope	40
2	Solucion per numerimin dhe diferencimin e WBC per aparatin Hematologjik	cope	50
3	Kit per matjen sasiore te Kreatinines (Metoda Jaffe) ne serum dhe plasem	Test	19 000
4	Kit per matjen sasiore te Urese ne serum plasem dhe urine	Test	19 000
5	Kit per matjen sasiore te Glukozes ne serum, plasem, urine dhe CSF	Test	19 000
6	Kit per matjen sasiore te Alanine Aminotranferases ne serum dhe plasem	Test	13 000
7	Kit per matjen sasiore te Aspartat Aminotransferases ne serum dhe plasem	Test	13 000
8	Kit per matjen sasiore te Bilirubines Totale ne serum dhe plasem tek neonatet dhe adultet	Test	11 000
9	Elektrode per matje e Cl-	cope	3
10	Elektrode per matjen e Potasiumit (K+)	cope	3
11	Elektrode per matjen e Sodiumit (Na+)	cope	3
12	Kit per matjen e proteines c reaktive	Test	9 000
13	Stripe urine te cilat analizohen (lexohen) ne aparat	Test	7 000
14	Kit per matjen sasiore te Kolesterolit për ekzaminimi laboratorik : Lipid.Total	Test	7 000

15	Kit per matjen sasiore te HDL për ekzaminimi laboratorik : Lipid.Total	Test	6 000
16	Kit per matjen sasiore te LDL për ekzaminimi laboratorik : Lipid.Total	Test	6 000
17	Kit per matjen sasiore te Triglicerideve për ekzaminimi laboratorik : Lipid.Total	Test	7 000
18	Kit per matjen sasiore te Acidit Urik	Test	4 000
19	Kit per matjen sasiore te Bilirubines Direkte ne serum dhe plasem	Test	3 000
20	Kit per matjen sasiore te Kalciumit ne serum, plasem dhe urine	Test	2 500
21	Kit per matjen sasiore te Albumines ne serum dhe plasem	Test	2 500
22	Kit per matjen sasiore te TSH imunologjike	Test	5 000
23	Kit per matjen sasiore te Proteinave Total	Test	2 500
24	Kit per matjen sasiore te HbA1c	Test	3 000
25	Kit per matjen sasiore te D Dimerit imunologjike	Test	3 000
26	Kit per matjen sasiore te Kreatinine Kinases ne serum dhe plasem	Test	1 800
27	Kit per matjen sasiore te Alkaline Fosfatases ne serum dhe plasem	Test	1 600
28	Kit per matjen sasiore te Gamma Glutamyl Transferase 2 (GGT- 2) ne serum	Test	2 500
29	Reagent per matjen e aPTT me metoden SDV ose ekuivalent	kuti	17
30	Buffer OWren Koller (24 x 15 mL) ose ekuivalent	kuti	6
32	Reagent per percaktimin e Kohes se Aktivizimit te Tromboplastines (aPTT: 6 x 2 mL) ose ekuivalent	kuti	9
33	Kit per matjen sasiore te Faktorit Reumatologjik	Test	2 000
34	Reagent per matjen e PT/INR me metoden SDV ose ekuivalent	kuti	15

35	Reagent CaCl ₂ 0.025 M (24 x 15 mL) ose ekuivalent	kuti	4
36	Reagent per matjen e kohes se Protrombines CI+5 (PT: 6 x 5 mL) ose ekuivalent	kuti	15
37	Kit per matjen sasiore te FT4 imunologjike	Test	2 200
38	Kit per matjen sasiore te FT3 imunologjike	Test	2 200
39	Kit per matjen sasiore te LDH	Test	1 400
40	Kit per matjen sasiore te Troponin I imunologjike	Test	7 000
41	Kit per matjen sasiore te Ferritines imunologjike	Test	2 500
42	Reagent likuid per matjen sasiore te Fibrinigenit me metoden Clauss (12 x 4 mL) ose ekuivalent	kuti	10
43	Kit per matjen sasiore te CKMB	Test	2 000
44	Kit per matjen sasiore te Hekurit	Test	1 000
45	Kit per matjen sasiore te PSA totale imunologjike	Test	1 200
46	Kit per matjen sasiore te Fosforit	Test	500
47	Kit per matjen sasiore te TPO neperjet metodes imunologjike	Test	900
48	Kit per matjen sasiore te Magnesiumit	Test	500
49	Kit per matjen sasiore te Triglicerideve	Test	1 000
50	Kit per matjen sasiore te Amilases ne serum plasem dhe urine	Test	400
51	Kit per matjen sasiore te Kolesterolit	Test	1 000
52	Kit per matjen sasiore te CEA imunologjike	Test	400
53	Kit per matjen sasiore te HDL	Test	1 000
54	Kit per matjen sasiore te LDL	Test	1 000
55	Katrixh per matjen e gazeve elektroliteve dhe Kalciumit te jonizuar ne gjak x 25 teste ose ekuivalent	kit	30

56	Kit per matjen sasiore te Lipases nëpërmjet medtodës kolorimetrike	Test	250
57	Kit per matjen sasiore te CKMB imunologjike	Test	500
58	Kit per matjen sasiore te CA 19-9 imunologjike	Test	400
59	Kit per matjen sasiore te FPSA imunologjike	Test	300
60	Kit per matjen sasiore te PROBNP imunologjike	Test	500
61	Kit per matjen sasiore te komplementit C4	Test	300
62	Kit per matjen sasiore te komplementit C3	Test	300
63	Kite per matjen sasiore te Cholinestrases	Test	300
64	Kit për matjes cilësore të HBV (HbsAg) imunologjike	Test	300
65	Kit për matjes cilësore të HCV (anti HCV) imunologjike	Test	300
66	Rapid test feçe gjak okult	Test	300
67	Rapid test për helikobakter në feçe	Test	300

Afatet e lëvrimnit: Afati i lëvrimnit për 12 muaj

Argumentim: Sasia dhe Grafiku i levrimit jane vendosur bazuar te procesverbalit nr. 1158/2 date 14/09/2023 te komisionit te hartimit i specifikimeve teknike per kite reagente për procedurën e prokurimit me objekt: **“Blerje Kite Reagentë për Laboratorin Klinik-Biokimik”**si dhe ne perputhje me nenin 4,pika 38/b, nenin 36 te **Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik”**, nenin 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

NJËSIA E PROKURIMIT: